



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHITËRPCËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtërpcës (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtërpcës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B1 Mungesa e planit për subvencionim të Organizatave Jo Qeveritare(OJQ-ve).

B2 Menaxhim jo i duhur i pasurive.

B3 Mungesë e procesit të inventarizimit të pasurive jo financiare.

B4 Mungesë e verifikimit të plotë të pronave komunale

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtërpcës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtërpcës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtërpcës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtërpçës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtërpçës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, llogarive të arkëtushme, trajtimin e pasurive jo financiare, të cilat janë paraqitur më poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, të gjithat janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mungesa e planit për subvencionim të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ-ve)

- Gjetja** Rregullorja MF nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 6, paragrafi 1, përcakton se; Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
- Gjatë auditimi, kemi vërejtur se komuna nuk kishte hartuar një plan për subvencionimin, financimin dhe mbështetjen e OJQ-ve për vitin 2025, kërkesë kjo ligjore e Rregullores MF nr 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, mbi bazën e të cilës komuna ka financuar këto organizata.
- Mungesa e një plani vjetor për subvencionimin e OJQ-ve kishte ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës dhe mosfunksionimit të kontroleve të brendshme për të hartuar një plan për të subvencionim të tyre.
- Ndikimi** Subvencionimi i OJQ-ve pa një planifikim vjetor të miratuar nga ekzekutivi ndikon negativisht në transparencën si dhe trajtimin jo të barabartë të OJQ-ve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të hartohet dhe miratohet plani vjetor për financimin publik të subvencioneve në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Menaxhim jo i duhur i pasurive

- Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nenit 2, paragrafit , përkufizon se “ të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit efektiv, efikas, ekonomik dhe me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi”.
- Në vitin 2012, Komuna e Shtërpçës kishte kompletuar ndërtimin e objektit spitalor me një vlerë 1,647,157€, i njëjti ishte pranuar edhe teknikisht. Pas kësaj periudhe, objekti spitalor është furnizuar me pajisje mjekësore. Objekti spitalor edhe në vitin 2025 nuk është funksionalizuar. Edhe pse objekti spitalor ende nuk është funksionalizuar vlera e tij në regjistrat e pasurisë është zhvlerësuar për 542,189€. Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara edhe katër ndërtesa banimi në vlerë prej 2,709,075€ të përfunduara për më shumë se nëntë (9) vite më parë, të cilat ende nuk janë pranuar teknikisht.
- Sipas zyrtarëve përgjegjës komunal ndërtesat janë dëmtuar në masë të

konsiderueshme dhe janë në gjendje jo funksionale.

Dobësitë në kontrolle kanë rezultuar me një menaxhim jo efikas të procesit të funksionalizimit të objektit spitalor i cili përpos që nuk është në funksion konformë dedikimit të tij për kujdesin ndaj komunitetit, është duke shkaktuar kosto vjetore të konsiderueshme për mirëmbajtjen e tij.

Ndikimi

Shpenzimet e larta të ndërtimit të kapaciteteve spitalore, pajisjeve mjekësore si dhe infrastrukturës përcjellëse, përfshirë edhe kostot vjetore të cilat komuna, është duke i paguar çdo vit në mungesë të funksionalizimit dhe përdorimit efektiv të spitalit kanë ndikuar në humbje financiare për komunën si dhe vlerë të munguar për para.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bënë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mungesë e procesit të inventarizimit të pasurive jo financiare

Gjetja

Rregullorjanr. 02/2013 - Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.6 dhe 4.7, kërkon që “Komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit” si dhe komisioni është përgjegjës gjithashtu që “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”. Ky proces duhet ti paraprijë përgatitjes së PFV-ve.

Në vitin 2012, Komuna e Shtërpçës kishte kompletuar ndërtimin e objektit spitalor me një vlerë 1,647,157€, i njëjti ishte pranuar edhe teknikisht. Pas kësaj periudhe, objekti spitalor është furnizuar me pajisje mjekësore. Objekti spitalor edhe në vitin 2025 nuk është funksionalizuar. Edhe pse objekti spitalor ende nuk është funksionalizuar vlera e tij në regjistrat e pasurisë është zhvlerësuar për 542,189€. Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara edhe katër ndërtesa banimi në vlerë prej 2,709,075€ të përfunduara për më shumë se nëntë (9) vite më parë, të cilat ende nuk janë pranuar teknikisht.

Menaxhmenti nuk është duke e trajtuar me kujdes çështjen e pasurive, kjo tregon mungesë të theksuar të kontrollit të brendshëm në komunë dhe si rezultat i kësaj gjendja e pasurive në komunë është në nivel të ulët të menaxhimit.

Ndikimi

Mungesa e përgatitjes së raportit të inventarizimit ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe në pasqyrat financiar vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e paligjshëm të pasurisë.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin efektiv të kontrolleve dhe mbikëqyrjen e komisionit të inventarizimit, në mënyrë që raporti të sigurohet

para përgatitjes së PFV-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mungesë e verifikimit të plotë të pronave komunale

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, respektivisht nenit 15, paragrafi 2, i përcakton se; veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha subjekteve tatimore të regjistruara për tatimin mbi pronën e paluajtshme brenda territorit të Komunës.

Komuna edhe në këtë vit nuk kishte arritur të plotësojë kërkesat e ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Në vitin 2025, komuna nga 5,171 objekteve, prej tyre kishte arritur të inspektoj (verifikojë) vetëm 311 objekte ose afërsisht 2.7%.

Mos verifikimi i pasurisë së paluajtshme/objekteve ka ndodhur për shkak të mungesës së zyrtareve komunale të mjaftueshëm në sektorin e tatimit pronë për të kryer inspektime dhe mos funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshme në kuadër të aktiviteteve për verifikimin e pronave.

Ndikimi

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë dhe inkasimin e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë verifikimin vjetor të së paku 20% të pronave të paluajtshme dhe përditësimin e saktë të ndryshimeve në regjistrat përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike: mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.

Çështja B5 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregullja Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore, dhe urdhërave përmbartimore gjatë vitit 2025 transaksione në vlerë 42,356€ ishin realizuar për punonjësit e arsimit (pagat jubilarë dhe shujta) nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 16,676€, nga mallrat dhe shërbimet 12,151€, si dhe nga subvencionet 13,529€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 14,935,864€, pasurive jokapitale është 81,789€, si dhe e stoqeve 2,485€.

Çështja B6 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, nenit 11, paragrafi 3 përcakton se; pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€, kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 20 pasuri në vlerë 3,141,389€, si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2014-2024, pjesa me e madhe e këtyre pasurive për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimi teknik për pasuritë e përfunduar, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Mos regjistrimi i drejtë i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive jofinanciare të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e mbivlerësuar.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduar dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna ka raportuar llogari të arkëtueshme (LI/A) në PFV për vitin 2025 në vlerë prej 4,515,214€, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 414,247€.

Çështja B7 - Menaxhimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 21.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ligj i lartë shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përmbartimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Megjithatë, procedura përmbartimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përmbartimit ndaj vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.

Në Pasqyrën Vjetor Financiar për vitin 2025, komuna ka paraqitur të arkëtueshmet (LLA) në vlerë prej 4,515,214€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë dhe parcela. Krahasuar me një vit më parë, shuma totale e borxhit për tatimin në pronë është rritur rreth 10%. Megjithatë komuna kishte marrë disa masa për të rritur inkasimin e borxheve, këto masa ishin të pamjaftueshme dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është në rritje.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe funksionimin e njësive përgjegjëse për të siguruar menaxhim efektiv të të hyrave dhe arkëtim në kohë të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,777,735	4,887,719	4,503,451	4,313,962	4,556,879
Grante Qeveritare - Buxheti	4,374,022	4,186,895	4,060,766	3,792,059	4,144,435
Të bartura nga viti i kaluar	0	297,111	140,723	287,054	194,606
Të hyrat vetanake	403,713	403,713	301,961	234,849	217,838

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për vlerën 109,984€ ose rreth 2%, që tregon rritje të buxhetit gjatë vitit fiskal.

Në vitin 2025, janë shpenzuar 4,503,451€, që përfaqëson rreth 92% të buxhetit final, duke reflektuar një nivel të mirë të realizimit të buxhetit.

Burimi kryesor i financimit mbetet Grantet Qeveritare - Buxheti, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të fondeve. Përveç kësaj:

Të barturat nga viti i kaluar në vlerë 297,111€ kanë kontribuar në rritjen e buxhetit final dhe në financimin e aktiviteteve gjatë vitit;

Të hyrat vetanake në vlerë 403,713€ përbëjnë një burim të rëndësishëm shtesë financimi.

Krahasuar me vitin 2024 dhe 2023, vërehet një rritje e shpenzimeve në vitin 2025.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,777,735	4,887,719	4,503,451	4,313,962	4,556,879
Pagat dhe mëditjet	3,296,820	3,109,693	3,109,693	3,033,591	2,966,979
Mallrat dhe shërbimet	557,954	608,728	549,560	485,919	497,886
Komunalitë	107,000	107,000	87,669	69,993	70,279
Subvencionet dhe transferet	100,000	158,191	122,209	125,222	49,940
Investimet Kapitale	715,961	904,107	634,320	599,237	971,796

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike buxhetore janë si më poshtë:

- Buxheti final për pagat dhe mëditjet është më i ulët për 187,127€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në 3,109,693€, që përfaqëson 100% të buxhetit final, duke reflektuar stabilitet dhe ekzekutim të plotë në këtë kategori.
- Buxheti final për mallrat dhe shërbimet është më i lartë për 50,774€, krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet arritën në 549,560€, që përfaqëson rreth 90% të buxhetit final.
- Buxheti final për komunalitë është i njëjtë me atë fillestar (107,000€), ndërsa realizimi i shpenzimeve është 87,669€, që përfaqëson rreth 82% të buxhetit final.
- Buxheti final për subvencionet dhe transferet është rritur për 58,191€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në 122,209€, që përfaqëson rreth 77% të buxhetit final, duke treguar një nivel më të ulët të realizimit krahasuar me kategoritë tjera.
- Buxheti final për Investimet kapitale është rritur për 188,146€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet arritën në 634,320€, që përfaqëson rreth 70% të buxhetit final, duke treguar sfida në realizimin e plotë të projekteve kapitale.

Në përgjithësi, struktura e shpenzimeve dominohet nga pagat dhe mëditjet, ndërsa investimet kapitale dhe subvencionet kanë nivel më të ulët të realizimit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Buxheti fillestar dhe ai final për të hyrat ishte 403,713€, ndërsa realizimi në vitin 2025 arriti në 303,020€, që paraqet një realizim prej rreth 75% të planifikimit buxhetor. Realizimi i të hyrave ka të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat administrative, etj.

- Të hyrat tatimore janë realizuar në 232,039€, që përfaqëson rreth 85% të planifikimit dhe mbeten burimi kryesor i të hyrave;

- Të hyrat jo tatimore janë realizuar në 68,986€, që përfaqëson rreth 52% të buxhetit të planifikuar, duke treguar nën-realizim në këtë kategori;

- Të hyrat tjera janë realizuar në vlerë minimale (1,995€), me ndikim të vogël në total.

Krahasuar me vitin 2024 dhe 2023, vërehet një rënie e të hyrave në vitin 2025, që mund të jetë rezultat i efikasitetit më të ulët në mbledhjen e të hyrave dhe planifikimi jo adekuat.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	403,713	403,713	303,020	316,084	343,332
Të hyrat tatimore	271,702	271,702	232,039	228,670	267,609
Të hyrat jo tatimore	132,011	132,011	68,986	72,939	75,723
Të hyrat tjera	0	0	1,995	14,474	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 ka rezultuar me tetë (8) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, një (1) rekomandim është zbatuar dhe shtatë (7) rekomandime nuk janë zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ- ve, të hartohet dhe miratohet plani vjetor për financimin publik të subvencioneve në përputhje me kërkesat ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet për hartimin e planit për vitin 2025.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Komuna ka arrit të paguaj të gjitha obligimet me kohë.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bënë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve dhe monitorimin e komisionit të inventarizimit në mënyrë që raporti inventarizimit të hartohet me kohë, respektivisht para hartimit të PFV-ve.	Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë raportin për inventarizim as këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.		Nuk ka filluar zbatimi
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leterkonfirmimi

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e
OB-së lidhur me raportin e auditimit

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtërpçës, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ivica Tanasijević

Pozita: Kryetar i Komunës

Data: 25.maj.2026.

Nënshkrimi:

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.